



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0502-A0001

***Në ankesën e***

***Paditësi/Ankuesi***

**M H** nga fshati M, Ferizaj.

***Kundër***

***E paditura***

**N.SH. "Banka Themelore e Kosovës" (në likuidim)**, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-7519 të datës 04 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 28 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-7519 i datës 04 gusht 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 17 dhjetor 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN125-0110 të datës 24 nëntor 2014, me të cilin atij i ishte refuzuara kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej datës 31.12.1990 deri më 12 qershor 1999, në shumë prej 360.00 euro per çdo muaj, nga NSH "Banka Themelore e Kosovës"- Prishtinë.

Paditësi në ankesë është deklaruar se Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar kërkesën si e pa vlefshme me arsyetimin është parashkruar sipas nenit 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar. Tutje ka shtuar se gjatë vitit 1990 është larguar forcërisht nga puna duke ia shkëputur kontratën e punës, dhe se është ankuar me shkrim po ankesa nuk është protokolluar nga punëdhënësi, ndërsa për shkak të masave të dhunshme dhe gjendjes së jashtëzakonshme nuk ka mundur të bëjë ankesë në gjykatë. Paditësi ka bashkangjitur si dëshmi Vendimin e AL PRN 125-0110, dhe kopjen e dokumentit identifikues.

Me 04 korrik 2022, Gjyqtari i Shkallës së I-rë, me urdhër ka kërkuara nga paditësi që të dorëzoj si prova : kontratën e punës, dëshmi në lidhje me lartësinë e pagës mujore, ndonjë provë se ka kërkuar pagat e papaguar gjatë viteve që e kërkon kompensimin nga NSH-ja.

Me 21 korrik 2022, paditësi me parashtrësë ka dorëzuar: vendimin mbi radhitjen e në punë dhe detyra të punës dt. 18 korrik 1983, vendimin për zgjedhjen e kandidatit në vendin e punës referent dt. 02 shtator 1997, Aktvendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dt. 27 dhjetor 1990 për shkak të falimentimit, Aktvendimin për caktimin e akontacionit të ardhurave personale dt. 30 shkurt 1990 dhe një kopje të letërnjoftimit.

Me 26 korrik 2022, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034.

Më tej e paditura pohoi se një kërkesë monetare e çfarëdo lloji që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi duhet të jetë paraqitur para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare nga momenti kur NSH-ja supozohet të mos i ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit nga viti 1991. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me 04 gusht 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-7519 e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar, dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se kërkesa për paga është parashkruar, pasi që paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi provë të besueshme se i njëjti ka iniciuar kontest të punës në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të procedurës së falimentimit. Në rastin konkret aktvendimi i datës 27 dhjetor 1990, meqenëse nuk është goditur nga paditësi me propozim/padi në Gjykatë Themelore të Punës së Bashkuar, ka prodhuar efekt juridik, ashtu që edhe kanë përfunduar të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në mes paditësit si punëtor dhe të paditurës si punëdhënës më 27 dhjetor 1990. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se është parashkruar kërkesa për kompensimin e pagave, sepse kërkesa ka arritur më 01 janar 1991, e tutje ndërsa kërkesa kreditore është ushtruar më 04 gusht 2014, që do të thotë se në momentin e ushtrimit ajo ishte parashkruar, sipas nenit 87 të Ligjit të punës 03/L-212.

Me 01 shtator 2022, paditësi/ankuesi e ka dorëzuar një ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGS, C-IV-14-7519 të datës 04 gusht 2022 për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i atakuar, duke e aprovuar ankesën e paditësit, për kompensimin e të ardhurave personale nga data 31 dhjetor 1990 e deri më 12 qershor 1999, edhe atë për çdo muaj nga 360 euro, ose i njëjti aktgjykim të prishet dhe të kthehet në Shkallë të I-re. Paditësi në ankesën e parashtruar pranë Kolegjit të Apelit ka pohuar që ka qenë në marrëdhënie pune, pranë Bankës Themelore të Kosovës deri në vitin 1990 kur edhe është larguar forcërisht nga puna. Paditësi thekson se është fakt që ka ushtruar ankesë kundër vendimit mbi largimin mirëpo nuk i është protokolluar ankesa nga organet e

dhunshme të atëhershme që është fakt i njohur botërisht se si ka funksionuar pushteti i atëhershëm, ku ai nuk ka pasur as mundësin me të vogël të kërkojë protokollim apo çfarëdo veprimi tjetër ngase kanë qenë organet e dhunshme të instaluar në atë kohë. Ankuesi në ankesën e parashtruar në kolegjin e apelit konsideron se Shkalla e I-re e DHPGJS-së ka bërë shkelje të rëndë të procedurës, në momentin kur nuk e pranon ankesën e ushtruar me kohe si të afatshme, e që me vetëm se i mungon vula e protokollimit, dhe ku nuk i merr fare parasysh pretendimet tona si palë kërkuese dhe e dëmtuar.

Po ashtu ankuesi konsideron se ai ka dorëzuar edhe provat materiale më 21 korrik 2022 si vendimi i punëtorit në punë datës 18 korrik 1985, vendimi për zgjidhjen e kandidatit në vendin e punës për referent për pagesa të datës 02 shtator 1977, aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 27 dhjetor 1990, aktvendimi për caktimin e akontacionit të ardhurave personale të datës 30 shkurt 1990, të gjitha këto prova dhe Gjykata i përmend në aktgjykim mirëpo nuk i merr si prova relevante e që është e pa pranueshme kjo forme e të vepruarit nga Gjykata.

Me 19 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj kësaj ankese. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar në mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktgjykimin me nr.C-IV.-14-7519 të DHPGJS-së, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar ankesa e paditësit dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

## **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj i njëjti duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me 04 gusht 2014 kishte parashtruar kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën prej 31 dhjetor 1990 deri në 12 qershor 1999, në shumë prej 360 euro për çdo muaj nga NSH "Banka Themelore e Kosovës"- Prishtinë. Autoriteti i Likuidimit kishte marrë vendim PRN125-0110 me të cilin e kishte e kishte refuzuar si të pa vlefshme kërkesën për arsye parashkrimit sipas nenit 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e I-rë kishte marrë Aktgjykimin me të cilin e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar, dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi ka dështuar të dorëzoji prova në mbështetje të kërkesës dhe prova për të vërtetuar ndërprerjen e parashkrimit, andaj është i saktë konstatimi i Autoritetit të Likuidimit dhe i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa për paga për periudhën e cekur është parashkruar. Paditësi e ka respektuar afatin procedural duke e paraqitur kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit me datë 04 gusht 2014, por në at kohë kërkesa e paditësit për paga ishte e parashkruar.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet pretendimet e paditësit në ankesën e parashtruar pranë Kolegjit të Apelit i cili pohon se ka sjellë prova të mjaftueshme materiale më 21 korrik 2022 si vendimi i punëtorit në punë datës 18 korrik 1985, vendimi për zgjidhjen e kandidatit në vendin e punës për referent për pagesa të datës 02 shtator 1977, aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 27 dhjetor 1990, aktvendimi për caktimin e akontacionit të ardhurave personale të datës 30 shkurt 1990.

Kolegji i Apelit konstaton se këto prova nuk janë prova relevante të cilat mund ta ndryshojnë gjendjen faktike të Aktgjykimit të ankimuar pasi që marrëdhënia e punës së ankuesit me NSH "Banka Themelore e Kosovës" ka përfunduar në vitin 1990,

ndërsa çdo punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi dhe që e ka burimin nga marrëdhënia kontraktuale midis dy palëve duhet të jetë paraqitur në gjykatë apo në ndonjë Autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur N.SH-ja supozohet të mos ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi/ankuesi ka dështuar ta respektoj afatin material prej tri viteve, brenda të cilit mund të kërkohet e drejta në paga. Paditësi është dashur të kërkoj përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Paditësi kërkon kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej 31 dhjetor 1990 deri me 12 qershor 1999. Kjo kërkesë e paditësit është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar, që i bie se afati i parashkrimit për pagën e fundit ka arritur në qershor të vitit 2002, ndërsa paditësi kërkesën e ka parashtruar me 04 gusht 2014, që do të thotë jashtë çdo afati të paraparë ligjor.

Paditësi/Ankuesi as me ankesën në Shkallen e I-rë, dhe as me ankesën në Shkallen e II-të nuk ka sjell prova me të cilat ai do të vërtetonte se këto paga i ka kërkuar brenda 3 viteve në Gjykatën Kompetente.

Prandaj nga këto arsye ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore:**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 21 shtator 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 28 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues \_\_\_\_\_